



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**  
**Telecommunications Regulatory Authority**  
**Regulativni Autoritet Telekomunikacije**



**Nr. Prot. 89/1/10**

**VENDIM Nr. 33**

**“Vendosja e tarifave në terminimin e thirrjeve në mes operatorëve PTK sh.a.  
/Vala dhe IPKO Telecommunications LLC”**

Bordi i ART-së i përbërë nga

- |                      |         |
|----------------------|---------|
| 1) z. Ekrem Hoxha    | Kryetar |
| 2) z. Besnik Berisha | Anëtar  |
| 3) z. Lulzim Kurtaj  | Anëtar  |
| 4) z. Naser Shala    | Anëtar  |
| 5) z. Nijazi Ademaj  | Anëtar  |

në mbledhjen e datës 19.10.2010, shqyrtoi dokumentin e përgatitur nga Departamenti i Telekomunikacionit (Ref. Aneks A), duke pas dhe marrë për bazë argumentet, faktet dhe rrethanat e mëposhtme;

- 1) Tarifat e ndërlihdjes (interkoneksionit) luajnë rol të rëndësishëm për stimulimin e konkurrencës reale në sektorin e telefonisë mobile,
- 2) Zvogëlimi i këtyre tarifave do të stimuloj një rritje të konkurrencës dhe krijimin e kushteve të barabarta dhe jo-diskriminuese për të gjithë operatorët/ofruesit e shërbimeve telekomunikuese,
- 3) Shkallën e zvogëlimit të tarifave të terminimit të thirrjeve mobile në shtetet e BE-së dhe më gjerë, si dhe nivelin aktual të tyre në Republikën e Kosovës,
- 4) Gjendjen aktuale të trafikut të zhvilluar ndërmjet operatoreve mobil, ku mbi 95% e trafikut realizohet brenda rrjetit (On-net),
- 5) Operatorët në propozimet e tyre nuk kanë ofruar ndonjë argument të qëndrueshëm, i cili do t'i arsyetonte propozimet e tyre, për më tepër kur

vlerësohet se nuk arsyetohet rritja e tarifave të terminimit krahasuar me nivelin aktual,

- 6) Tarifat e larta të terminimit mund të qojnë në rritje të çmimeve me pakicë për origjinimin e thirrjeve dhe së këndejmi të rezultojnë me shkallë të ulët të shfrytëzimit, duke zvogëluar në këtë mënyrë mirëqenien e konsumatorit,
- 7) Tarifat e ulëta të interkoneksionit do të ndikojnë që operatorët të orientohen në prezantimin e produkteve të reja me çmime atraktive në mënyrë që të rrisin numrin e përdorueseve,
- 8) Për terminimin e thirrjeve në rrjetin mobil jo të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë arritur ose janë në proces të arritjes së çmimeve të bazuara në kosto të një operatori efikas,
- 9) Zvogëlimi i tarifës së interkoneksionit nuk mund të ndikoj (ose shumë pak e besueshme) në rritjen e dukurisë së orientimit ilegal të trafikut (ang. Grey traffic) e njohur si **Sim-to-Sim**.

dhe me qëllim që ART të,

- a) Realizoj obligimin e saj për të krijuar kushtet e barabarta dhe një ambient të favorshëm për një konkurrencë të mirëfilltë për të gjithë operatorët/ofruesit e shërbimeve telekomunikuese,
- b) Përbushë objektivin për të ndjekur parimet dhe principin e mbrojtjes së interesit të shfrytëzuesve, promovimit të risive dhe zhvillimit të gjithëmbarshtëm të sektorit të telekomunikacionit,
- c) Nxisë lëvizjen e çmimeve në korrelacion sa më të afërt me koston dhe paraqitjes së shërbimeve të reja, të cilat sjellin përfitime më të mëdha për konsumatorin,
- d) Realizoj zgjidhje, të cilat janë plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, direktivat dhe rekomandimet e BE-së, dhe praktikatat më të mira të shteteve rajonale dhe ndërkombëtare.

ndërlidhur me vendosjen e tarifave të interkoneksionit ndërmjet operatorëve mobil, Bordi i ART-së, në përputhje me kompetencat e saja ligjore dhe procedurat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të ART-së, vendosi si më poshtë,

## V E N D I M

- 1) Obligohen operatorët e telefonisë mobile që të zbatojnë tarifën **0.063 euro/min** për terminimin e thirrjeve mobile.
- 2) Tarifa e përcaktuar me dispozitivin e nenit 1 të këtij vendimi do të zbatohet në mënyrë retroaktive nga data 01 Maj, 2010.
- 3) Tarifa e vendosur me dispozitivin e nenit 1 të këtij vendimi do zbatohet për një periudhë një (1) vjeçare (1 Maj, 2010 deri 30 Prill, 2011).
- 4) Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga bordi i ART-së.

## BAZA LIGJORE

Vendimi, mbështetet në dispozitat e legjislacionin vijues, qoftë primar apo sekondar;

- A. Kapitulli 1, neni 1 alineja 1, dhe neni 6 alineja 1; Kapitulli 3 neni 11 alineja 7; Kapitulli 10, neni 53, alineja 3, neni 56, alineja 7 dhe 8, të Ligjit për Telekomunikacion Nr. 2002/7, datë; 8 maj, 2003, i ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-085, datë; 13 Qershor, 2008;
- B. Dokumentin politikat e sektorit të telekomunikacionit të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, datë; 13 Qershor, 2007 (vendimi, ART Ref. Nr.02/255), **promovimin e konkurrencës dhe ambientit jo-diskriminues (2.1.);**
- C. Vendimin e ART-së Nr. 13 (ART Ref. Nr. 30/1/10/07).

### Këshilla Juridike

Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankesa. Ky vendim u nënshtrohet çfarëdo shqyrtimi përmes procedurave administrative gjyqësore të parapara me ligjet në fuqi.

### Vërtetim

Më këtë vendim konfirmohet se Bordi i ART-së ka vendosur në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së ART-së.

Prishtinë, dt. 21/10/2010

**Telekomunikacionit**

**Autoriteti Rregullator i**

Ekrem Hoxha  
Kryetar i Bordit

Besnik Berisha	Anëtar
Lulzim Kurtaj	Anëtar
Naser Shala	Anëtar
Nijazi Ademaj	Anëtar

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve
- Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit<sup>1</sup>
- Departamentit të Telekomunikacionit, ART
- Arkivit të ART-së

---

<sup>1</sup> Vetëm Aktvendimi pa Aneks Dokumentin, për shkak të respektimit të termeve mbi ruajtjen e konfidencialitetit